



Npi – 01/224 Datë: 27.08.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe nenin 40.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 30 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48; Nenit 16 të Ligjit për Buxhetin Nr.07/L-041 për vitin 2021; Ligji Nr. 08/l-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.07/l-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021; Udhëzimin Administrativ të Ministris së Financave Nr.05/2019. Si dhe mbi bazën e prezentimit të Propozim-Vendimit, të Zyrës Komunale për Financa, Nr.02/03/123 të datës: 18.08.202, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËR TRANSFER DHE RIALOKIM TË NDARJEVE BUXHETORE TË PROJEKTEVE KAPITALE PËR VITIN 2021

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më datën: 27.08.2021 me shumicën e votave aprovoi vendimin për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të projekteve kapitale për vitin 2021, si vijon:

- Mjetet e lira për Transfer nga programi buxhetor 93180 Arsimi Fillor, 93181, Fondi Burimor (10), kategoria e shpenzimeve INVESTIME KAPITALE (30).

Mjetet e mbetura nga projekti sipas tabelës në vazhdim:

Nr.:	Emri i Projektit	kodi i projektit	shuma e mbetur ne euro	Shuma per transfer dhe Rialokim
1	Përfundimi i ndërtimit të shkollës fillore “Avdullah Shabani” Caralevë	50980	19,589.90	19,000€
2	Përfundimi i shkollës fillore Lasgush Poradeci Muzeqinë	50982	8,170.68	3,000€
Total			27,759.68	

Mjetet të cilat kalojnë në projektin sipas tabelës në vazhdim:

Nr.	Emri i Projektit	kodi i projektit	shuma e mbetur ne euro	Shuma per transfer dhe Rialokim
1	Ndertimi dhe renovimi i objekteve shkollore në Komunën e Shtimës	89442		22,000€

II

A r s y e t i m: Për shkak të mbetjeve financiare nga projektet e kontraktuara dhe të realizuara, kemi mundësi të transferojmë dhe Ri-Alokojmë mjetet e lira në projektet në vazhdim dhe të kontraktuara sipas buxhetit të vitit 2021, si dhe në mungesë të realizimit të të hyrave vetanake, mund të shfrytëzojmë mundësinë e realizimit të projekteve kapitale.

III


Ridestinimi i Rezervës Buxhetore Komunale, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj